



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1642/12 Prot.

Tiranë, më 26.06 2023

V E N D I M

Nr. 76 dt. 26.06 2023

“PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN PËR ORGANIZIMIN E
PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË
UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”

Mbështetur në nenet 33 paragrafi 3, 38, 77 paragrafi 4 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.112, datë 23.02.2018 “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe të standarteve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor”, i ndryshuar, Udhëzimin e MAS nr.1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjesn, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 4, 20, 76 të Statutit të UST-së, në nenin 7 dhe 64 të Rregullores së UST-së, si dhe mbështetur në shkresën nr.1606/1 prot., datë 21.06.2023 të Komisionit të Përhershëm të Dhënies së Gradës Shkencore “Doktor” pranë Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Senati Akademik në datën 26.06.2023.

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në Rregulloren për organizimin e programeve të studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Universitetin e Sporteve të Tiranës (bashkëlidhur vendimit).
2. Ky vendim ti përcillet për njohje dhe zbatim njësisive kryesore si dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve e Digjitalizimit të Sherbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. **AGRON KASA**

